

VENDIM
Nr. 258, datë 29.4.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1243, DATË 11.12.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTEVE, QË DUHET TË PARAQESIN SHTETASIT E TË PROCEDURAVE, QË DUHET TË KRYEJNË ZYRAT E GJENDJES CIVILE NË BASHKI/NJËSI BASHKIAKE/KOMUNA DHE INSTITUCIONET SHTETËRORE, TË POSAÇME, PËR NDRYSHIMIN E VENDBANIMIT/ADRESËS SË SHTETASVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, pika 4, 20, pika 4, e 22, pika 2, të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr.1243, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Në titullin e vendimit, fjalët “... njësi bashkiake/komuna ...” zëvendësohen me “... njësi administrative ...”.
 2. Kreu I, “Parime të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shtetasit me banim në territorin e Republikës së Shqipërisë kryejnë regjistrimin ose ndryshimin e vendbanimit të tyre në rrugë elektronike (*on-line*), nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në portalin qeveritar “*e-Albania*”, duke depozituar dokumentin e pronësisë së banesës, kontratën e qiramarrjes, huadhënies, përdorimit ose çdo dokument tjetër të ligjshëm që provon vendbanimin.

Dokumentet e ngarkuara në portalin qeveritar “*e-Albania*” nga shtetasi, që provojnë regjistrimin ose ndryshimin e vendbanimit të ri, ruhen në arkivin elektronik të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.
 2. Anëtari madhor i familjes, i cili kërkon të regjistrojë ose të ndryshojë vendbanimin, më parë duhet të kryejë procedurën e veçimit, si familje më vete në rrugë elektronike (*on-line*), përmes paraqitjes së kërkesës nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi.
 3. Shtetasi, i cili kërkon të bashkohet në një familje, paraqet kërkesën në rrugë elektronike (*on-line*) nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, duke depozituar në portal konfirmimin e të gjithë anëtarëve madhorë të familjes pritëse, duke pasur në konsideratë standardet e banimit, të miratuara nga legjislacioni në fuqi.”.
 3. Në kreun II, “Veprimet që kryhen nga institucionet shtetërore, dokumentacioni i nevojshëm dhe afatet e komunikimit”, pikat 5 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. Lista emërore e hartuar nga institucionet e parashikuara në pikën 4, të këtij vendimi, duhet të përmbajë emrin, mbiemrin dhe numrin personal. Kjo listë i dërgohet zyrës së gjendjes civile përkatëse nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik.
 8. Për regjistrimin e vendbanimit të ri të shtetasve, të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, institucionet shtetërore komunikojnë nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik për shkëmbimin e dokumenteve të mëposhtme:
 - a) Listës emërore, ku shënohen emri, mbiemri dhe numri personal;
 - b) Dokumentit që vërteton vendbanimin për rastet e shtetasve që banojnë jashtë ndërtesave të institucionit.”.
 4. Në kreun III, “Veprimet e zyrave të gjendjes civile”, pikat 10 dhe 11 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“10.Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për regjistrimin e vendbanimit të shtetasve të huaj e të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm, në Republikën e

Shqipërisë, pasi merr njoftimin dhe aktet përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit apo zyra, që mbulon shtetësinë dhe refugjatët, i kërkon në rrugë elektronike zyrës së gjendjes civile, ku këta shtetas kanë të përcaktuar vendbanimin e tyre, të bëjë regjistrimin, sipas afateve të përcaktuara në lejen e qëndrimit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

11. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pas marrjes së dokumentacionit e të kërkesës nga shtetasit dhe nga institucionet që e kanë këtë detyrim ligjor, bën ndryshimin e adresës së shtetasit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me urdhër të ministrit, që mbulon gjendjen civile.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj